



FEDERATA E SHENJËTARISË SPORTIVE E KOSOVËS  
SPORTSKA STRELJAČKA FEDERACIJA KOSOVA  
KOSOVO SHOOTING SPORT FEDERATION

Adresa: Rr. "Agim Ramadani" Nr. 43. Shtëpia e Sporteve Prishtinë, Kosovë.

Tel: +381 (0) 38 244 473

e-mail: [info@fshsk.org](mailto:info@fshsk.org), [gezim.hazrolli@fshsk.org](mailto:gezim.hazrolli@fshsk.org)

---

## **RREGULLORE MBI RREGULLAT E PËRGJITHSHME TEKNIKE TE GARAVE**

Prishtinë 11.11.2022

Në bazë të nenit 22, alineja 2.15 të Statutit të FSHSK-së, Këshilli drejtues në mbledhjen e vetë tëmbajtur më 11.11.2022 miratoi:

## **RREGULLORE MBI RREGULLAT E PËRGJITHSHME TEKNIKE TË GARAVE TË Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës**

1

### **TË PËRGJITHSHME**

1.1

#### **Objektivi dhe qëllimi i rregullave teknike**

FSHSK përcakton rregullat teknike për të drejtuar realizimin e garave të sportit të shenjëtarisë të njohura nga ISSF (Rregulloret e Përgjithshme të ISSF, 3.3). Qëllimi i rregullave teknike të FSHSK është uniformitetit në zhvillimin e sportit të shenjëtarisë në të gjithë botën.

a) **Rregullat e Përgjithshme Teknike të FSHSK** përfshijnë rregullat për ndërtimin e fushës, caqeve, shënimin e rezultateve dhe procedurat specifike garuese për të gjitha disiplinat e shenjëtarisë.

Rregullat zbatohet posaçërisht për dy (2) disiplina të shenjëtarisë: **Pushkë dhe Pistoletë ajrore 10m,**

b) **Rregullat e përgjithshme teknike dhe ato të disiplinave të ISSF-së** miratohen nga Këshilli Drejtues në pajtim me Statutin e FSHSK-së;

1.2

#### **Zbatimi i rregullave të përgjithshme teknike dhe ato të disiplinave**

a) Rregullat e Përgjithshme Teknike dhe ato të Disiplinave të ISSF-së duhet te aplikohen në të gjitha garat vendore duke përfshirë edhe kampionatet e FSHSK;

b) Të gjithë zyrtarët e garave, garuesit, trajnerët dhe udhëheqësit e ekipit duhet të jenë të njohur me rregullat e FSHSK -së dhe ti zbatojnë ato;

c) Është përgjegjësi e çdo garuesi të veprojë në përputhje me këto rregulla;

ç) Kur një Rregull i referohet garuesëve të djathtë, zbatohet e kundërta e kësaj për garuesit e majtë;

dh) Përveç nëse një Rregull zbatohet në mënyrë specifike për garat e meshkujve apo femrave, duhet të zbatohet në mënyrë të njëjtë/uniforme për meshkuj dhe femra.

d) Kur diagramet dhe tabelat në këto rregulla përmbajnë informacion specifike, informacioni specifik në këto diagrame dhe tabela ka të njëjtin autoritet si rregullat e numëruara.

1.3

#### **Fushëveprimi i rregullave teknike**

Rregullat Teknike përfshijnë:

a) Rregullat për përgatitjen dhe organizimin e garave dhe kampionatit;

b) Rregullat që zbatohen për të gjitha disiplinat e shenjëtarisë ose më shumë se një disiplinë e shenjëtarisë (Rregullat e Përgjithshme Teknike);

c) Rregullat që zbatohen për një disiplinë të shenjëtarisë (Rregullat Teknike të Veçanta).

1.4

#### **Standardet për Pajisje dhe Veshje**

Shenjëtaria është një sport ku pajisjet dhe veshmbathjet luajnë role kritike në zhvillimin e këtij sportit. Garuesit duhet të përdorin vetëm pajisjet dhe veshjet që përputhen me Rregullat e ISSF. Çdo armë, pajisje ose sende të tjera që mund ti japi garuesit një avantazh i padrejtë mbi të tjerët dhe që nuk përmendet në mënyrë specifike në këto Rregulla, ose që është në kundërshtim me frymën e këtyre Rregullave, është e ndaluar. Rregullat e ISSF për pajisjet dhe veshjet zbatohen

në mënyrë rigoroze për të siguruar se asnjë garues nuk ka veshje apo pajisje që u japin atyre përparësi të padrejtë ndaj garuesëve tjerë.

#### Përkufizimet dhe shkurtesat

Më poshtë janë përkufizimet e termave dhe shkurtesave të veçanta që përdoren si Rregullat e Përgjithshme Teknike në FSHSK.

Numri Bib / Start Numri.	Çdo garuesi që ka hyrë në gare dhe Kampionat i lëshohet një Bib apo numër startues unik. Këta numra përdoren për të identifikuar dhe ndjekur konkurrentët dhe duhet të barten në shpinën e garuesëve gjatë trajnimit dhe garës.
Kursi I zjarrit	Një përshkrim i fazave të gares brenda një ngjarjeje që specifikon Numri i qitjeve në secilën seri dhe fazë, lloji i qitjes dhe afatet kohore.
CRO	Chief Range Officer Zyrtari Kryesor i Zonës
Electronic scoring target(s)	Caqet elektronike, Objektivi elektronik i vlerësimit të pikeve
FOP Field of Play	Fusha e lojës. Në qitje, FOP përfshin zonën pas vijës së qitjes ku qasja është e kufizuar për garuesit konkurrentë dhe zyrtarët e garës,
MATCH Shots	Pikët ose rekordi i të shtënave që numërohen në rezultatin e një garuesi.
Medal Match	Duele që vendosin renditjen përfundimtare të katër garuesëve me të mirë.
Min.	Minut
PET	Trajnimi para garës
RTS	Rezultatet, Kohëzgjatja dhe Shënimi. Procesi i RTS është pjesë e operacioneve të gares që përfshin përgatitjen e listave fillestare, caqet elektronik, goditjen e objektivave, nxjerrjen e rezultateve, përgatitjen dhe shpërndarjen e listave të rezultateve.
Series	Një sekuencë e goditjeve brenda një faze. Garat me pushke dhe pistolet ajrore 10m, kanë seri me 10 qitje.
Start List	Listat fillestare në caqe elektronike. Dokumentet zyrtare të prodhuara në gara që tregojnë të gjithë konkurrentët e futur në gare
Start Time	Koha e fillimit të garës.
Team Events	Garat e ekipore që janë të përfshira në Kampionatin Botëror, Evropian etj.

2

## **SIGURIA**

### **SIGURIA ËSHTË TEJET E RËNDËSISHME**

2.1

#### **Rregullat e Përgjithshme të Sigurisë**

2.2

Rregullat e FSHSK-së, vendosin kërkesa specifike të sigurisë të cilat duhet të zbatohen në të gjitha garat dhe kampionatet e FSHSK-së. Juria e FSHSK-së, dhe Komitetet Organizative janë përgjegjës për siguri.

2.3

Rregullat e domosdoshme dhe të veçanta të sigurisë për poligonin e qitjes ndryshojnë nga vendi në vend prandaj rregullat shtesë të sigurisë mund të krijohen nga Komiteti Organizativ. Gjyqtarët, zyrtarët e poligonit, zyrtarët e Klubeve dhe garuesit duhet të këshillohen për çdo rregull të veçantë të sigurisë në programin e garave.

2.4

Siguria e garuesëve, zyrtarëve të poligonit dhe spektatorëve në vazhdimësi kërkon kujdes ndaj mënyrës së trajtimit të armëve. Është detyrë e zyrtarëve të poligonit për të zbatuar masat e sigurisë për përdorimin e armës, ndërsa detyra e garuesëve dhe zyrtarëve të ekipit është për ti aplikuar ato.

2.5

FSHSK mund të refuzojë pranimin e hyrjes së një garuesi në një garë nëse ka informacion të konsiderueshëm nga autoritetet kompetente që një garues i tillë paraqet kërcënim serioz për sigurinë e të tjerëve në poligonin e qitjes.

2.6

Në interes të sigurisë, një anëtar i jurisë ose zyrtari i poligonit mund të ndalojë qitjen në ç'do kohë. Garuesit dhe zyrtarët e ekipit duhet menjëherë të njoftojnë zyrtarët e poligonit ose anëtarët e Jurisë për çdo situatë që mund të jetë e rrezikshme.

2.7

Zyrtari i Kontrollit të Pajisjeve, Zyrtari i poligonit ose Anëtar i Jurisë mund të marr pajisjet e garuesit (duke përfshirë armë) për kontroll pa lejen e tij, por në praninë e tij dhe me njohuritë e tij. Megjithatë, duhet të ndërmerren veprimet e menjëhershme kur është çështja e sigurisë.

3

### **Rregullat e Trajtimit të Armëve**

3.1

Për të ndërmarr masat e sigurisë, të gjitha armët duhet të trajtohen me kujdes maksimal në çdo kohë. Armët nuk duhet të largohet nga linja e qitjes gjatë trajnimit apo garës me përveç më leja nga zyrtari i poligonit.

3.2.

Flamujt e sigurisë të ndërtuara me fluoreshent ngjyrë portokalli ose një material të ngjashëm të ndritshëm duhet të vendoset në të gjitha pushkët, pistoletat dhe armët gjysmë automatike në çdo kohë përveç kur heqja e flamurit të sigurisë është e autorizuar nga këto rregulla. Për të demonstruar së armët e ajërti janë të zbrazua, flamujt e sigurisë (linjat e sigurisë) duhet të jenë të mjaftueshme të zgjatur përmes gjatësisë së plotë të tytës. Flamujt e sigurisë për të gjitha armët

tjera duhet të ketë një sondë që hyn në dhomën e fishekut (foleja e fishekut) për të demonstrua se është e zbrazët.

a) Nëse flamuri i sigurisë nuk përdoret siç kërkohet nga ky rregull, një anëtar i jurisë duhet të japë një paralajmërim me udhëzimet për të futur flamurin e sigurisë në armë;

b) Nëse Juria vërteton se një garues refuzon të përdorë një flamur të sigurisë siç kërkohet nga kjo rregullore dhe pasi të jetë paralajmëruar, garuesi duhet të diskualifikohet (DSQ).

### 3.3

Ndërsa garuesit janë në pikat e tyre të qitjes, armët e tyre gjithmonë duhet të drejtohen në drejtim të sigurt. Foleja e fishekut nuk duhet të mbyllet derisa arma të vihet në drejtim të sigurt drejt zonës së caqeve.

### 3.4

Kur vendosni armën poshtë ose kur qitja ka mbaruar, arma duhet të shkarkohen/zbrazet me veprimet (mekanizmi i mbylljes) i hapur dhe flamuri i sigurisë i futur. Para largimit nga vija e zjarrit, garuesi duhet të konfirmojë dhe zyrtari i poligonit duhet të verifikojë që nuk ka fishek ose në dhomën e fishekut dhe flamuri sigurie është futur.

### 3.5

Nëse garuesi heq kutin e armës ose çantën nga pika e zjarrit/qitjes pa u kontrolluar nga një zyrtar i poligonit, ai mund të diskualifikohet nëse Juria vendos se është shkelje e rëndë e sigurisë.

### 3.6

Gjatë qitjes, armë mund të vihet (nuk mbahet) vetëm pasi që fishekët /ose karikatorit janë hequr dhe mekanizmi është i hapur. Armët ajrore duhet të bëhen të sigurt më hapjen e levës ose portën se mbushjes.

### 3.7

Kur ndonjë personel është përpara vijës së qitjes, nuk lejohet përdorimi/mbajtja e armës dhe flamuri i sigurisë duhet të jetë futur. Nëse është e nevojshme për një anëtar të jurisë, qe zyrtari i poligonit ose zyrtari teknik të shkoj përpara linjës së qitjes gjatë trajnimit, garave ose finales, kjo duhet të autorizohet dhe kontrollohet nga zyrtari kryesorë i poligonit (CRO) dhe çdo lëvizje përpara vijës së zjarrit mund të lejohet pasi në të gjitha armët janë të futur flamujt e sigurisë.

### 3.8

Në poligon, kur armët nuk janë në vijat e zjarrit, ato gjithmonë duhet të jenë në kutit e tyre, përveç nëse autorizohet ndryshe nga zyrtari i poligonit.

## 4

### **Komandat në Poligon**

#### 4.1

Zyrtarët kryesorë i poligonit, apo zyrtarë të tjerë të përshtatshme të poligonit, janë përgjegjës për dhënien e komandave "mbush" ("LOAD"), " fillo " (START), " ndal " (STOP), " zbraz " (UNLOAD) dhe komandat tjera të nevojshme. Zyrtarët e poligonit duhet të sigurojnë që komandat janë zbatuar dhe se armët janë trajtuar në mënyrë të sigurt.

#### 4.2

Armët dhe magazinat (karikatorët) e tyre mund të mbushen vetëm në pikën e zjarrit pas komandës "mbush" (LOAD) ose " fillo" (START). Në të gjitha rastet e tjera, armët dhe magazina duhet të mbahen të zbrazura.

#### 4.3

Arma konsiderohet e ngarkuar/mbushur kur një fishek ose saçme ose një karikator me fishekë kontakton me armë. Askush nuk mund të vendosë një fishek, saçme ose karikator me fishek në armë para se të jepet komanda "mbush" (LOAD).

#### 4.4

Nëse një garues gjuan përpara se të jepet komanda "mbush" ose "fillo", ose pasi të jepet komanda "ndal" ose "zbraz", ai mund të diskualifikohet nëse janë cenuar masat e sigurisë.

#### 4.5

Kur jepet komanda ose sinjali "ndal", qitjet duhet të ndalen menjëherë. Kur jepet komanda "zbraz", të gjithë garuesit duhet të shkarkojnë armët e tyre dhe magazinën (karikatorin), dhe t'i bëjnë ato të sigurta (për të zbrazur armën ajrore pyesni zyrtarin e poligonit për leje). Qitja mund të rifillojë përsëri vetëm kur jepet komanda "fillo".

### 5

#### **Kërkesat shtesë të sigurisë**

##### 5.1

**Qitja e thatë** është tërheqja e këmbëzës së një armë të zbrazur ose lirimin e mekanizmit të shkrepjes së armës më ajër i pajisur me një pjesë që mundëson këmbëzën e shkrepjes të operoj pa u liruar ngarkesa. Stërvitja e thatë janë të lejuara vetëm në vijën e zjarrit ose në një zonë të caktuar në përputhje me këto rregulla.

##### 5.2

Është përgjegjësia e garuesit të sigurojë që çdo cilindër ajri ose CO2 është ende brenda datës së vlefshmërisë. Kjo mund të kontrollohet nga Kontrolli i Pajisjeve.

##### 5.3

#### **Mbrojtja e dëgjimit**

Në varësi të nevojës së garuesit ai ose ajo mund të mbajë mbrojtëse për vesh, mbrojtja e dëgjimit që inkorporon çdo lloj pajisje për përmirësimin ose marrjen e zërit nuk duhet të mbahen nga garuesit ose trajnerët. Garuesit me dëmtim të dëgjimit mund të mbajnë pajisje për përmirësimin e zërit me miratimin e jurisë.

### 6

#### **CAQET ELEKTRONIK DHE STANDARDET E CAQEVE ELEKTRONIKE**

##### 6.1

#### **Kërkesat e Përgjithshme të Caqeve elektronik**

##### 6.2

Caqet të cilat përdoren në garat dhe kampionatet e FSHSK-se, mund të jenë caqe elektronik për numrimin e pikeve me arme standarde dhe caqe elektromekanike për numrimin e pikeve me arme serike.

##### 6.3

Caqet elektronikete dhe elektromekanike që përdoren në garat dhe kampionatet e FSHSK-se, duhet të jenë në përputhje me unazën e vlerësimit të pikeve, sipas dimensionit ose specifikimeve të tjera të dhëna në këtë rregullore.

#### 6.4

### **Caqet elektronike–Shënimi i pikeve per arme Standarde**

Vetëm caqet elektronike te aprovuara dhe miratuar nga FSHSK mund të përdoren per shenimin e pikeve ne disiplinat me arme Standarde.

#### 6.5

Kërkesa e saktësisë për caqet elektronike është që të vleresoj qitjet me një saktësi të paktën gjysma e një decimale të unazës. Tolerancat e dhëna për madhësinë e unazës së rezultateve në shenjen e letrës nuk janë të zbatueshme për Caqet elektronike.

#### 6.6

Caqet elektronike duhet të sigurojnë një zonë të zezë ne mes te cakut që korrespondon më madhësinë e zonës se zezë të figures se letres (Rregulla 6.3.4), fushë jo reflektive, kontrast të bardhë që rrethon zonën e cakut elektronike.

#### 6.7

Pikët e regjistruara nga caqet elektronike duhet të përcaktohen sipas dimensioneve të unazës së rezultatit për caqet normale te letres.

#### 6.8

Çdo goditje në caqet elektronike duhet të ketë rezultatin e saj me vendndodhjen dhe vlerën e shfaqur në një monitor të vendosur në vijen e zjarrit, monitorin e audiences dhe monitorin e dhomes se kontrollit.

#### 6.9

Printim i rezultateve të çdo garuesi nga burimi i softverit, duhet të jetë i disponueshme menjëherë pas gares. Te gjitha rezultatet e gares duhet te ruhen ne memorien e kompjuterit te dhomes se kontrollit.

#### 6.10

Nën mbikëqyrjen e Delegatit Teknik, caqet elektronike duhet të kontrollohen për të siguruar se janë duke vleresuar në mënyrë korrekte në kushtet normale të përdorimit para çdo gare dhe kampionati të FSHSK-se.

### 7

### **Standardet e caqeve elektronik**

Caqet elektronik duhet të përputhen me dimensionet e unazës së shënimit, tolerances dhe specifikimeve në këtë rregullore.

#### 7.1

Rezultatet me vlerë decimale të unazës përcaktohen duke ndarë zonën e vlerësimit për një unazë të plotë në dhjetë Rrethit të barabartë të pikave që janë dizajnuar me vlera decimale duke filluar me zero (dmth. 100, 9.0, etj.) dhe duke përfunduar me nëntë ( 10.9, 9.9, etj);

#### 7.2

Te gjitha garat me pushke standarde vlersohen me decimale, (kualifikimi dhe finalja)

#### 7.4

Garat me pistolet standarde ne kualifikime vlersohen me numer te plote, ndersa ne finale me decimale.


#### 7.5

Te gjitha garat me pushke dhe pistolet serike vlersohen me numer te plote.

## Dimensionet e rrathve te caqeve elektronike

### 10m Caqe elektronike për Pushkë Ajrore

Rrethi 10	0.5 mm	(± 0.1 mm)	Rrethi 5	25.5 mm	(± 0.1 mm)
Rrethi 9	5.5 mm	(± 0.1 mm)	Rrethi 4	30.5 mm	(± 0.1 mm)
Rrethi 8	10.5 mm	(± 0.1 mm)	Rrethi 3	35.5 mm	(± 0.1 mm)
Rrethi 7	15.5 mm	(± 0.1 mm)	Rrethi 2	40.5 mm	(± 0.1 mm)
Rrethi 6	20.5 mm	(± 0.1 mm)	Rrethi 1	45.5 mm	(± 0.1 mm)




10m Figura për Pushkë Ajrore

### Figura per Pistoletë standarde ajrore 10m

10 Unaza	11.5 mm	(± 0.1 mm)	5 Unaza	91.5 mm	(± 0.5 mm)
9 Unaza	27.5 mm	(± 0.1 mm)	4 Unaza	107.5 mm	(± 0.5 mm)
8 Unaza	43.5 mm	(± 0.2 mm)	3 Unaza	123.5 mm	(± 0.5 mm)
7 Unaza	59.5 mm	(± 0.5 mm)	2 Unaza	139.5 mm	(± 0.5 mm)
6 Unaza	75.5 mm	(± 0.5 mm)	1 Unaza	155.5 mm	(± 0.5 mm)





10m Figurë Pistoletë Ajri

## 10

### **Caqet elektromekanike, figurat e letres–Shënimi i pikeve per arme Serike**

Vetëm caqet elektromekanike, figurat e letres te aprovuara dhe miratuar nga FSHSK mund të përdoren per shenimin e pikeve ne disiplinat me arme Serike.

#### 10.1

Kërkesa e saktësisë për figurat e letres është që të vleresoj qitjet me një saktësi per pike te plota.

#### 10.2

Caqet elektromekanike duhet të sigurojnë mbajtese te figures se letres e cila perbehet nga gjashte rrathe ne zonen e bardhe te shenuar me numra dhe tre rrathe ne zonen e zeze, rrethi shtate, tete dhe nente kan numra, ndersa rrethi 10 ka nje pike te bardhe dhe nuk ka numer.

#### 10.3

Numerimi i pikeve behet nga juria duke u bazuar ne shiqimin vizual te letres, rrathet numerohen me pike te plote, pa decimale.

Prishtinë 11.11.2022  
Kryetari i FSHSK-së  
Gëzim Hazrolli

